



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net, tel. 0280390112

RAPORT I KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK PËR ANGAZHIM NË SEMESTRIN DIMËROR DHE VEROR VITI AKADEMIK 2020/21

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike

Pozita e kërkuar sipas konkursit – Asistentët në lëndët e Teknologjisë Informatike, për semestrin dimëror dhe veror:

1. Programimi I, Algoritmet dhe struktura e të dhënave, Programim II; OOP.
2. Bazat e të dhënave, Databazë e avancuar (SEW), Shërbimet e bazuara në WEB (SEW), Zhvillimet për internet.
3. Sigurimi I kualitetit të softuerve, Vizualizimi dhe procesimi I imazheve (SEW), Hyrje në intelgjencën artificiale, Siguria e internetit (SEW), E- Qeverisja.
4. Inxhinieri souftuerike, Web design i avancuar (SEW), Informatikë, Hyrje në Programim, Web design, Sistemet kompjuterike, Sensorët dhe interfejsi, Ndërtimi I E-Businessëve, Softuerët aplikativ në matematikë, Sistemet operative dhe arkitektura e kompjuterëve, Algoritmet, Kompjuteristikë, Programet aplikative.
5. Arkitektura e Kompjuterëve & SO, Hyrje në grafikën e kompjuterëve, Sistemet e shpërndara, Rjetat dhe Cloud.
6. Matematika I për informatikë, Probabiliteti dhe statistika, Statistikë për e-qeversije, Matematika II për informatikë, Teoria e grafeve.

Kandidatët e paraqitur në konkurs:

1. Mag. Mentor Arifaj
Kandidati, Mentor Arifaj, ka të përfunduar studimet 5 vjeçare dhe magjistraturë 2 vjeçare në fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – Dega Kompjuterikë me Komunikacion, me notën mesatare 9.51. Ka një përvojë të gjatë në mësimdhënie si asistent I angazhuar në FIEK dhe në pozita të konsulentit profesional për fushën Teknologjisë Informatike. Gjithashtu ka përvojë pune si programer në disa kompani të njohura në Kanada.
Z. Arifaj ka aplikuar në të gjitha pozitat nga pozitat 1 deri 5.
2. Ing.Dipl. Ibadete Limani
Kandidatja Ibadete Limani ka të përfunduara studimet në FIEK, studime 5 vjeçare (Ing.Dipl.) të ekuivalentuara me MSc. Drejtimi i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – Dega Kompjuterikë me Komunikacion, me notën mesatare 7.28. Ka të përfunduara një

numër të trajnimeve, dhe nuk ka dëshmi mbi përvoj pune të mëhershme. Është paraqitur për pikën 6 dhe pjesërisht për pikën 1.

3. MSc. Enver Selmani

Kandidati Enver Selmani, ka të përfunduara studimet bachelor në Shkenca Kompjuterike në Universitetin e Evropës Juglindore, kurse ato të Masterit po në të njëjtin Universitet, me notë mesatare 6.87. Ka një numër trajnimesh dhe përvojë pune si programmer. Pa përvojë akademike. Ka aplikuar për pozicionin 2 dhe 4.

4. MSc. Adrian Krasniqi

Kandidati Adrian Krasniqi ka të përfunduara studimet bachelor në FIEK, Departamenti Inxhinieri Kompjuterike, me notë mesatare 7.76. Studimet Master i ka të përfunduara në po të njëjtin Fakultet dhe drejtim, me notën mesatare 8.75. Ka përvojë pune akademike në UKZ si dhe kompani tjera si programer. Ka aplikuar për pozicion 1, 2, 4 dhe 5.

5. MSc. Refik Ramadani

Refik Ramadani ka të përfunduara studimet bachelor në Universitetin e Evropës Juglindore, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, dhe në të njëjtin Universitet edhe studimet master me notë mesatare 7.87. Ka përvojë akademike në UKZ si dhe trajnime të ndryshme. Është PhD.Cand në Shkenca Kompjuterike në Universitetin "Kiril I Metodi" në Veliko Ternovo. Ka aplikuar për pozicionet 4 dhe 5.

6. MSc. Selami Klaiqi

Selami Klaiqi ka të përfunduara studimet bachelor në FIEK, Departamenti Inxhinieri Kompjuterike me notë mesatare 7.82. Studimet master I ka të kryera në UBT, Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri me notë mesatare 8.44, si dhe Masterin për Mësimdhënie në Teknologjinë Informativë në UP, Fakulteti i Edukimit me notë mesatare 8.67. Ka përvojë të gjatë pune si asistent I angazhuar në UKZ, si dhe trajnime të ndryshme. Është PhD.Cand në Shkenca Kompjuterike në Universitetin "Kiril I Metodi" në Veliko Ternovo. Ka aplikuar për pozitat 1, 3 dhe 5.

7. MSc. Liridon Hoti

Liridon Hoti ka të përfunduara studimet bachelor në FIEK, Departamenti Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike me notë mesatare 7.65. Studimet master i ka të kryera në të njëjtin fakultet me notë mesatare 8.06. Ka përvojë të gjatë pune si asistent I angazhuar në UKZ dhe kolegje tjera si dhe trajnime të ndryshme. Është PhD.Cand në Shkenca Kompjuterike në Universitetin "UNIBIT" në Sofie. Ka aplikuar për pozitat 2, 3 dhe 4.

8. Msc. Pajtim Rashiti

Kandidati, MSc.Pajtim Rashiti, ka të përfunduar studimet bachelor në kolegjin e Biznesit dhe Teknologjisë – UBT me notë mesatare 7.48, kurse studimet master në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore me notë mesatare 8.0. Ka një përvojë në mësimdhënie në Universitetin "Kadri Zeka", si dhe trajnime të ndryshme. Ka aplikuar për të gjitha pozitat 1 deri 5.

9. MSc. Mergim Hoti

Kandidati Mërgim Hoti ka të përfunduara studimet bachelor në UPZ, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike me notë mesatare 8.21, dhe studimet Master me notë mesatare 8.19 në po

të njëjtin Fakultet. Ka një angazhim një semestër në UPZ. Është PhD.Cand në Shkenca Kompjuterike në Universitetin e Evropës Juglindore. Ka aplikuar për pozicion 2 dhe 5.

10. MSc. Armend Saliu

Armend Saliu ka të përfunduara Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, në Universitetin e Prishtinës, FIEK me notë mesatare 8.26. Masterin e ka të kryer në UBT, Fakulteti I Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri me notë mesatare 8.72. Ka përvojë akademike në Universitetin e Prishtinës, në FSHMN si asistent. Është PhD.Cand në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, në Shkencat Kompjuterike. Ka aplikuar për pozicionin 1,2,3 dhe 5.

11. MSc.Qëndresë Morina

Qëndresë Morina ka të përfunduara studimet bachelor në UP – FSHMN në drejtimin Matematikë – Shkenca Kompjuterike, me notë mesatare 8.48 dhe ka të përfunduara studimet master në Fakultetin e Edukimit, në drejtimin Master I Mësimdhënies Lëndore me Specializim në Matematikë, në UP me notë mesatare 8.60. Ka përvojë akademike në UP si asistente e angazhuar, si dhe ka trajnime të ndryshme. Është PhD.Cand në Universitetin “Charles University” në Fakultetin e Edukimit në Pragë (Edukimi I Matematikës). Ka aplikuar për lëndët në pozicionin numër 6.

12. Msc. Hysnije Ismaili

Hysnije Ismaili ka të përfunduara studimet bachelor në UP – FSHMN në drejtimin Matematikë – Shkenca Kompjuterike, me notë mesatare 7.74 dhe ka të përfunduara studimet master në Universitetin e Evropës Juglindore, në Fakultetin e Shkencave të Teknologjisë Bashkohore në drejtimin Informatikë e Biznesit (nota mesatare nuk paraqitet). Ka përvojë akademike në UKZ dhe trajnime të ndryshme. Është PhD.Cand në Universitetin “Klement Ohridski” në Manastir. Ka aplikuar për pozicionin 6.

13. Astrit Ramizi

Astrit Ramizi ka krye studimet bachelor në UP – FSHMN, drejtimi Matematikë Arsimore, me notë mesatare 6.76. Studimet master I ka kryer në Universitetin e Tetovës, Fakulteti i Shkencave matematike-natyrore me notë mesatare 7.70. Nuk ka dëshmi mbi përvojën e punës. Ka aplikuar për pozicionin nr.6.

14. Anisa Isufi

Kandidatja Anisa Isufi, ka vetëm Kërkesën e protokolluar, në të cilën dëshmon se ka aplikuar për lëndët nga Gjuha Angleze në FSHK, por që nuk kanë qenë në konkursin e shpallur nga FSHK, prandaj si e tillë nuk mund të shqyrtohet, pasi që nuk kemi të dhëna të tjera nga Kandidatja.

15. Msc. Avni Rudaku

Kandidati Avni Rudaku, ka vetëm Kërkesën e protokolluar, në të cilën dëshmon se ka aplikuar për lëndët nga Shkrimi Akademik në FSHK, që nuk kanë qenë në konkursin e shpallur nga FSHK, prandaj kjo kërkesë si e tillë nuk mund të shqyrtohet Është PhD.Cand për Sociologji në UP.

16. Vjollca Bahtiri

Kandidatja Vjollca Bahtiri ka të përfunduara studimet superior (program I vjetër) në UP, Fakultetin e Shkencave matematike-Natyrore, me notë mesatare 7.37, kurse studimet

master në Fakultetin e Edukimit në UP, programi Mësimdhënie Lëndore me specializim në matematikë. Nuk ka përvojë akademike. Ka aplikuar për lëndët e matematikës nga pozicioni 6.

VLERËSIM

Komisioni në përbërje:

1. Prof.Asoc. Dr. Artan Dermaku - Kryetar
2. Prof.Ass. Dr. Ragmi Mustafa - anëtar,
3. Prof.Ass. Dr. Kastriot Dermaku - anëtar;

duke u bazuar në Rregulloren mbi procedurat e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm - me honorar në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan, pasi shqyrtoi të gjitha aplikacionet e dorëzuara për këtë pozitë, i propozon Këshillit të Fakultetit që kandidatët, si më poshtë:

- Për pozitën nr. 1 sipas konkursit propozohet kandidati **PhD.Cand. Selami Klaiqi**. Kandidati në fjalë plotëson kushtet sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm. Është PhD Kandidat. Ka një përvojë të gjatë si asistent në UKZ po për këto lëndë si dhe një performancë pozitive si nga profesorët ashtu edhe nga studentët.

Kandidatët tjerë të paraqitur për këtë grup lëndësh:

- Mentor Arifaj, është propozuar për një grup tjetër lëndësh
 - Ibadete Limani nuk i plotëson kushtet e konkursit sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm, neni 13.2, por edhe nga aspekti i përvojës si dhe kushteve tjera është në disfavor.
 - Adrian Krasniqi, i plotëson pjesërisht kushtet e konkursit sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm, por nuk përzgjedhet, pasi që ka më pak përvojë pune akademike, është në disfavor pasi që nuk është PhD kandidat si dhe gjatë një angazhimi paraprak ka vërejtje nga stafi dhe studentët.
 - Armend Saliu është propozuar për një grup tjetër lëndësh
 - Pajtim Rashiti është propozuar për një grup tjetër lëndësh.
- Për pozitën nr. 2 sipas konkursit, lëndët ndahen në dy asistentë paraprakisht të përzgjedhur për lëndë tjera, pasi që sipas CV dhe përvojave janë më të afërt.

Mag. Mentor Arifaj propozohet për lëndët Bazat e të Dhënave; Shërbimet e bazuara në Ëeb. Këto lëndë kandidatit i shtohen në grupin e lëndëve që veq është përzgjedhur nga programi master në E-Qeverisje. Kandidati në i fjalë plotëson kushtet sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm. Ka një përvojë të gjatë si asistent në UP si dhe përvoja të shumta si ekspert brenda dhe jashtë Kosovës.

PhD.Cand. Liridon Hoti propozohet për lëndët Databazë e Avancuar; Zhvillimet për Internet. Këto lëndë kandidatit i shtohen në grupin e lëndëve me numër 3, për të cilat veq është përzgjedhur. Ka përvojë të gjatë pune si asistent I angazhuar në UKZ dhe kolegje tjera si dhe trajnime të ndryshme. Është PhD.Cand në Shkenca Kompjuterike.

Kandidatët tjerë të paraqitur për këtë grup lëndësh:

- Enver Selmani nuk I plotëson kushtet e konkursit sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm, neni 13.2, por edhe nga aspekti I përvojës si dhe kushteve tjera është në disfavor.
- Adrian Krasniqi, I plotëson pjesërisht kushtet e konkursit sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm, por nuk përzgjedhet, pasi që ka më pak përvojë pune akademike, është në disfavor pasi që nuk është PhD kandidat si dhe gjatë një angazhimi paraprak ka vërejtje nga stafi dhe studentët.
- Pajtim Rashiti është propozuar për një grup tjetër lëndësh.
- Armend Saliu është propozuar për një grup tjetër lëndësh
- Mergim Hoti i plotëson kushtet e konkursit sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm, por nuk përzgjedhet, pasi që ka më pak përvojë pune akademike sesa kandidatët tjerë.

- Për pozitën nr. 3 sipas konkursit, propozohet **PhD.Cand. Liridon Hoti**. Kandidati në fjalë ka përvojë të gjatë pune si asistent I angazhuar në UKZ dhe kolegje tjera si dhe trajnime të ndryshme. Është PhD.Cand në Shkenca Kompjuterike, si dhe një performancë pozitive si nga profesorët ashtu edhe nga studentët.

Kandidatët tjerë të paraqitur për këtë grup lëndësh:

- Mentor Arifaj, është propozuar për një grup tjetër lëndësh
- Selami Klaiqi, është propozuar për një grup tjetër lëndësh
- Pajtim Rashiti, është propozuar për një grup tjetër lëndësh
- Armend Saliu, është propozuar për një grup tjetër lëndësh

- Për pozitën nr. 4 sipas konkursit, lëndët ndahen në dy asistentë paraprakisht të përzgjedhur për lëndë tjera, pasi që sipas CV dhe përvojave janë më të afërt.

Msc. Pajtim Rashiti propozohet për të gjitha lëndët nga ky grup, përveq dy lëndëve si më poshtë të cilat I janë caktuar asistentit Refik Ramadani; Pajtim Rashiti ka një përvojë të gjatë si asistent në UKZ po për këto lëndë apo të ngjashme si dhe ka një performancë pozitive si nga profesorët ashtu edhe nga studentët.

PhD.Cand. Refik Ramadani propozohet për lëndët Sensorët dhe Interfejsi; dhe Ndërtimi I E-Bussineseve. Refik Ramadani ka një përvojë më të gjatë si asistent në UKZ po për këto lëndë apo të ngjashme si dhe ka një performancë të kënaqshme.

Kandidatët tjerë të paraqitur për këtë grup lëndësh:

- Mentor Arifaj, është propozuar për një grup tjetër lëndësh
- Enver Selmani nga aspekti I përvojës si dhe kushteve tjera është në disfavor.

- Liridon Hoti, është propozuar për një grup tjetër lëndësh
 - Adrian Krasniqi, I plotëson pjesërisht kushtet e konkursit sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm, por nuk përzgjedhet, pasi që ka më pak përvojë pune akademike, është në disfavor pasi që nuk është PhD kandidat si dhe gjatë një angazhimi paraprak ka vërejtje nga stafi dhe studentët.
- Për pozitën nr. 5 sipas konkursit, propozohet **PhD.Cand. Armend Saliu**. Kandidati në fjalë ka të përfunduara fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, në Universitetin e Prishtinës, I plotëson kushtet sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm dhe ka përvojë akademike në Universitetin e Prishtinës, në FSHMN si asistent. Është PhD.Cand.

Kandidatët tjerë të paraqitur për këtë grup lëndësh:

- Mentor Arifaj, është propozuar për një grup tjetër lëndësh
 - Refik Ramadani, është propozuar për një grup tjetër lëndësh
 - Pajtim Rashiti, është propozuar për një grup tjetër lëndësh
 - Selami Klaiqi, është propozuar për një grup tjetër lëndësh
 - Liridon Hoti, është propozuar për një grup tjetër lëndësh
 - Mergim Hoti I plotëson kushtet e konkursit sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm, por nuk përzgjedhet, pasi që ka më pak përvojë pune akademike sesa kandidatët tjerë.
 - Adrian Krasniqi, i plotëson pjesërisht kushtet e konkursit sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm, por nuk përzgjedhet, pasi që ka më pak përvojë pune akademike, është në disfavor pasi që nuk është PhD kandidat si dhe gjatë një angazhimi paraprak ka vërejtje nga stafi dhe studentët.
- Për pozitën nr. 6 sipas konkursit, propozohet **PhD.Cand. Qëndresë Morina**. Kandidatja në fjalë ka të përfunduara studimet bachelor në UP – FSHMN në drejtimin Matematikë – Shkenca Kompjuterike, me notë mesatare 8.48 dhe ka të përfunduara studimet master në Fakultetin e Edukimit, në drejtimin Master I Mësimdhënies Lëndore me Specializim në Matematikë, në UP me notë mesatare 8.60. Ka përvojë akademike në UP si asistente e angazhuar, si dhe ka trajnime të ndryshme. Është PhD.Cand në Universitetin “Charles University” në Fakultetin e Edukimit në Pragë (Edukimi I Matematikës). Ka aplikuar për lëndët në pozicionin numër 6.

Kandidatët tjerë të paraqitur për këtë grup lëndësh:

- Hysnije Ismaili, i plotëson pjesërisht kushtet e konkursit sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm, por edhe pse ka përvojë si asistente në UKZ nuk përzgjedhet pasi që ka notën më të vogël mesatare sesa kandidatja tjetër, por edhe është më pak e përafërt me fushat e kërkuara në konkurs.
- Ibadete Limani, nuk i plotëson kushtet e konkursit sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm. Gjithashtu fusha e studimeve nuk përkon me lëndët në konkurs.
- Astrit Ramizi, nuk i plotëson kushtet e konkursit sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm.

- Vjollca Bahtiri, nuk i plotëson kushtet e konkursit sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm.

Komisioni:

Gjilan, 21.10.2020

1. Prof.Asoc. Dr. Artan Dermaku - Kryetar



2. Prof.Ass. Dr. Ragmi Mustafa - anëtar,



3. Prof.Ass. Dr. Kastriot Dermaku - anëtar;

